

Dokument për Politika Publike

Ndërtimi i autostradave dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Shkup, 2024

Dokument për Politika Publike

Ndërtimi i autostradave dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Projekti

Organizatrat civile në veprim për ndryshime klimatike

Zbatues

Projekti zbatohet nga Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor “Eko-svest” në bashkëpunim me Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë-SHJRM dhe Organizata Lidhja e Vlerave Natyrore dhe Njerëzve-CNVP

Autore

Bojana Bozhinovska Siljanovska

Redaktor

Goce Kocevski dhe Bojan Trpevski

Redaktimi gjuhësor në maqedonisht

Eleonora Stojkoska – Popetrevska

Përkthimi në shqip

Rexhep Xheladini

Dizajni grafik

Haris Muriq

Shkup, 2023



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit “Organizatrat civile në veprim për klimën”, mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

PËRMBAJTA

1

Lista e shkurtesave

2

Hyrje

3

Metodologjia

4

Ndërtimi i autostradave dhe përgjegjësitë për infrastrukturën e gjelbër

6

Përmbajtja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisin Jetësor

8

Krijimi i detyrueshëm i raporteve ndaj vlerësimeve të ndikimit në mjedisin jetësor

10

Progresi në ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d

12

Nevoja për rrjetë funksionale hekurudhore në RMV

13

Konkluzionet dhe rekomandimet

15

Literatura e përdorur

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|-------|---|
| OSHC | Organizatat e shoqërisë civile |
| BE | Bashkimi Evropian |
| VNM | Vlerësimi i ndikimit në mjedis jetësor |
| MMJPH | Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor |
| SHJRM | Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë |
| RM | Republika e Maqedonisë |
| RMV | Republika e Maqedonisë së Veriut |

HYRJE

Infrastruktura rrugore dhe autostradat luajnë rol jetik në shoqëritë moderne duke lidhur njerëzit dhe mallrat në distanca të mëdha. Megjithatë, ndërtimi dhe përdorimi i këtyre sistemeve të transportit ka ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Ndikimi më i rëndësishëm i infrastrukturës rrugore dhe autostradave në mjedisin jetësor është emetimi i gazeve serrë, veçanërisht dioksidi i karbonit, i cili kontribuon në ndryshimet klimatike. Sektori i transportit është përgjegjës për rreth 14% të emetimeve globale të gazeve serrë, ku transporti rrugor përbën shumicën e këtyre emetimeve.¹ Në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV), transporti zë 28% dhe është në vendin e dytë në burimin më të madh kombëtar të emetimeve të gazrave serrave, gjegjësisht sektori i energjisë. Parashikimet për vitin 2050 tregojnë se emetimet e gazrave serrave nga transporti do të ulen me një përqindje të vogël, pra do të arrijnë në 22%. Prandaj, ulja e ndikimit të transportit në ndryshimet klimatike qëndron lartë në agjendën e Bashkimit Evropian (BE), por edhe në agjendën tonë kombëtare.²

Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave shpesh përfshin pastrimin e habitateve natyrore, duke çuar në shpyllëzimin dhe humbjen e biodiversitetit. Ky shkatërrim i ekosistemeve natyrore mund të ketë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin jetësor, duke përfshirë humbjen e habitatit për jetën e egër dhe kërcënimin e shërbimeve të ekosistemit.

Shërbimet e ekosistemeve janë përfitimet që njerëzit marrin nga ekosistemet natyrore, duke përfshirë ajrin dhe ujin e pastër, pllenimin dhe rregullimin e klimës. Shkatërrimi i habitateve natyrore mund të ketë ndikim të rëndësishëm në këto shërbime, duke sjellë pasoja negative për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve.³

E gjithë kjo është arsyeja pse është e nevojshme të kryhet një vlerësim i ndikimit në mjedisin jetësor. Në këtë drejtim, Bashkimi Evropian përcakton qartë dhe pa mëdyshje se vlerësimi i ndikimit në mjedis jetësor (VNM) është bërë i detyrueshëm⁴ kur është fjala për ndërtimin e autostradave dhe e njëjta përfshinë efektin e ndryshimeve klimatike me ndërtimin dhe përdorimin e një autostrade të tillë.

1 Më shumë të dhëna statistikore mbi emetimet e transportit mund të gjenden në ueb-faqen: www.statista.com

2 Beti Angjelevska dhe Zharko Haxhi Zafirov, 2023. Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV nga këndvështrimi i ndikimit në ndryshimet klimatike, SHJRM, Shkup

3 Ehsan Ashouri, The Impact of Road and Highway Infrastructure on the Environment and Climate Change

4 Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisin Jetësor 2011/92/BE dhe ndryshimi 2014/52/BE, Aneksi 1 në lidhje me nenin 4(1).

METODOLOGJIA

Dokumenti është përgatitur si vazhdimësi e dokumentit tashmë të publikuar të politikave publike “Korridoret 8 dhe 10d - A kemi garanci të mjaftueshme që ndërtimi i autostradave nuk do të ketë ndikim negativ në fondin pyjorë?”. Pas publikimit, dokumenti u nda me të gjitha institucionet përkatëse dhe u mbështet më tej nga një letër motivuese nga Koalicioni për Klimën. Hulumtimi për këtë temë, veçanërisht rregullimi ligjor, u nxit nga projekti i paralajmëruar për ndërtimin e autostradave në korridoret 8 dhe 10d, të cilat në një pjesë të caktuar duhet të kalojnë edhe nëpër pyje. Për të përcaktuar gjendjen aktuale, janë dërguar disa kërkesa për qasje të lirë në informacione publike dhe janë konsultuar raportet dhe analizat përkatëse. Në periudhën paraprake, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë (SHJRM) në mënyrë aktive ka punuar në analizimin e akteve nënligjore lidhur me këtë temë, kështu që për shkak të konstatimit të mospërputhjeve në kundërshtim me Kushtetutën e RMV-së, filloi një iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë që iu dorëzua Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, dokumenti “Ndërtimi i autostradave dhe mbrojtja e mjedisit jetësor” përmbledh të gjitha njohuritë e deritanishme lidhur me ndërtimin e autostradave, rregullimin ligjor, të drejtën e BE-së dhe nevojën për infrastrukturë të gjelbër. Dokumenti i politikave publike jep konkluzione dhe rekomandime specifike për përmirësimin e rendit juridik, në drejtim të arritjes së qasjes në drejtësi, sigurisë juridike dhe në fund mbrojtjes reale të mjedisit nëpërmjet ligjit si instrument.

Dokumenti “Ndërtimi i autostradave dhe mbrojtja e mjedisit jetësor” është përgatitur në kuadër të projektit “Organizatave civile në veprim për ndryshimet klimatike”. Për të rritur ndikimin e organizatave të shoqërisë civile në procedurën legjislative, janë duke u përgatitur një sërë dokumentesh që synojnë disa politika publike që u përgjigjen sfidave kryesore dhe ofrojnë rekomandime. Dokumenti është përgatitur në lidhje me standardet përkatëse të BE-së. Dokumenti trajtohet si një analizë ligjore e sfidave të caktuara dhe një produkt për përfaqësimin e pikëpamjeve, të destinuara për përdorim nga Organizatat Shoqërisë Civile (OSHC) nga Koalicioni për Klimën dhe më gjerë.

NDËRTIMI I AUTOSTRADAVE DHE PËRGJEGJËSITË PËR INFRASTRUKTURËN E GJELBËR

Infrastruktura e gjelbër përkufizohet si «një rrjet i planifikuar strategjikisht i zonave natyrore dhe gjysmë-natyrore me veçori të tjera ekologjike, i projektuar për të ofruar një gamë të gjerë shërbimesh ekosistemit dhe në të njëjtën kohë për të forcuar diversitetin biologjik»⁵. Shërbime të tilla përfshijnë, pastrimin e ujit, përmirësimin e cilësisë së ajrit, sigurimin e hapësirës për rekreacion, si dhe ndihmën në zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike. Ky rrjet i hapësirave të gjelbra (tokësore) dhe kaltër (ujore), e përmirëson cilësinë e mjedisit jetësor, gjendjen dhe lidhjen e zonave natyrore, si dhe përmirëson shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Zhvillimi i infrastrukturës së gjelbër mund të mbështesë gjithashtu ekonominë e gjelbër dhe të krijojë mundësi pune. BE-ja promovon përdorimin e infrastrukturës së gjelbër dhe të kaltër dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të mirën e qytetarëve të BE-së dhe biodiversitetit. Strategjia e BE-së për Infrastrukturën e Gjelbër synon të ruajë, rivendosë dhe përmirësojë infrastrukturën e gjelbër për të ndihmuar në ndalimin e humbjes së biodiversitetit dhe për të mundësuar ekosistemet të ofrojnë shërbimet e tyre për njerëzit. Strategjia e BE-së për Biodiversitetin 2030⁶ promovon investimet në infrastrukturën gjelbër dhe të kaltër, si dhe integrimin sistematik të ekosistemeve të shëndetshme, infrastrukturës së gjelbër dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë në planifikimin urban. Zhvillimi i infrastrukturës së gjelbër mund të lehtësohet nga integrimi i saj i mëtejshëm në mjetet për planifikimin hapësinor, VNM dhe vlerësimin strategjik në mjedisin jetësor.

Në RMV ende nuk ka një qasje të integruar në fushën e transportit përmes së cilës do të zbatohet një politikë e reduktimit të sasisë së karbonit të prodhuar nga automjetet, por ekziston vetëm një rregullim i pjesshëm i këtij segmenti. Për sa i përket kuadrit ligjor, RMV-ja ka një qasje të fragmentuar, sepse nuk ka asnjë akt ligjor mbi bazën e të cilit do të zbatohen qëllimet strategjike të përcaktuara qartë të Strategjisë Kombëtare të Transportit 2018-2030. Qasja e fragmentuar është e evidente nga fakti se vetëm disa ligje rregullojnë çështjen e parandalimit të emetimeve të karbonit nga automjetet në lloje të ndryshme të trafikut.

Asnjë referencë e drejtpërdrejtë nuk i bëhet infrastrukturës së gjelbër⁷ në fushat e planifikimit hapësinor, transportit, ujit, biodiversitetit dhe ruajtjes së natyrës. Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i vlefshëm deri 2020⁸ dhe RMV-ja nuk ka miratuar një plan të ri hapësinor pas vitit 2020. Termi «infrastrukturë e gjelbër» nuk përmendet në dokumentet apo ligjet e planifikimit kombëtar apo vendor.⁹

⁵ Strategjia e BE-së për Infrastrukturën e Gjelbër - përmirësimi i kapitalit natyror të Evropës /^{*} COM/2013/0249

⁶ Strategjia e BE-së për Biodiversitetin për vitin 2030 COM(2020) 380

⁷ Termi «infrastrukturë e gjelbër» është relativisht i ri. Elementë të caktuara në të si: mbrojtja e zonave natyrore, ujërave dhe etj., janë objekt i mbrojtjes në disa ligje ekzistuese.

⁸ Plani hapësinor i RM-së deri 2002-2020

⁹ Teodora Obradović Grncarovska në bashkëpunim me Marijačara Alberton, Qershor 2020, Focus Report Republic of North Macedonia, EURAC Research Baseline Assessment and Gap analysis of climate change framework, EIA and SEA requirements, with a particular focus on road infrastructure, UNDP, Shkup, fq. 18


Edhe pse në vitin 2020 u miratua Ligji i ri për planifikimin urbanistikë¹⁰ nuk bën asnjë referencë apo angazhim për infrastrukturën e gjelbër, as nuk e përmend apo e përkufizon atë si term. Megjithatë, ligji i referohet në mënyrë të përsëritur mjedisit jetësor.

Sipas Ligjit për Ndërtim,¹¹ Projekti themelor i ndërtimit, pra projekti i infrastrukturës për objektet e infrastrukturës lineare, përmban një studim për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor, pra një raport për mbrojtjen e mjedisit të miratuar nga një autoritet kompetent, nëse rregulloret në fushën e mjedisit jetësor parashikojnë përgatitjen e një studimi, gjegjësisht një elaborat për këtë lloj infrastrukture.

Sipas nenit 6 të të njëjtit ligj, ndërtimet duhet të kryhen në mënyrë që të shmangen ndikimet në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, kurse materialet e ndërtimit duhet të përdoren në mënyrë që të mos shkaktojë rrezik. Përsëri nuk ka asnjë referencë për termin «infrastrukturë e gjelbër».¹²

Projekti bazë për ndërtesat që ndodhen brenda ose pranë ujërave sipërfaqësore, ndërtesat që kalojnë mbi ose nën ujërat sipërfaqësore, ndërtesat që ndodhen pranë ujërave sipërfaqësorë ose tokave bregdetare, të cilat mund të ndikojnë në regjimin e ujit si dhe për objektet e menaxhimit të ujit të përcaktuara me Ligjin për Ujërat, përmban edhe pëlqimin për menaxhimin e ujit¹³, përveç VNM-së.

E fundit por jo edhe nga rëndësia, për sa u përket planeve strategjike¹⁴ të shtetit, mund të thuhet se problemi i infrastrukturës së gjelbër nuk konsiderohet drejtpërdrejt ose vetëm indirekt përfshihet në dokumentet strategjike.¹⁵



¹⁰ Teodora Obradoviq Grncarovska në bashkëpunim me Mariaciara Alberton, Qershor 2020, Focus Report Republic of North Macedonia, EURAC Research Baseline Assessment and Gap analysis of climate change framework, EIA and SEA requirements, with a particular focus on road infrastructure, UNDP, Shkup, fq. 18

¹¹ Ligji për planifikim urbanistikë Gazeta Zyrtare e RMV-së 32/2020, 111/2023

¹² Ligji i Ndërtimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së 130/09..., 115/2023, neni 45-a dhe 47.

¹³ Teodora Obradoviq Grncarovska në bashkëpunim me Mariaciara Alberton, Qershor 2020, Focus Report Republic of North Macedonia, EURAC Research Baseline Assessment and Gap analysis of climate change framework, EIA and SEA requirements, with a particular focus on road infrastructure, UNDP, Shkup, fq. 18

¹⁴ Ligji i Ndërtimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së 130/09..., 115/2023, neni 47 paragrafi 8

¹⁵ Strategjia Kombëtare e Transportit të RMV-së 2018-2030

PËRMBAJTJA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDISIN JETËSOR

Rregullorja për përmbajtjen e kërkesave që duhet të plotësojë studimi i vlerësimit për projektin ndikimi në mjedisin jetësor¹⁶ përcakton që studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor duhet të përmbajë një përshkrim dhe të dhëna teknike për projektin, një përshkrim të mjedisit jetësor dhe llojet dhe sasinë e emetimeve të pritshme, si dhe informacione të tjera të nevojshme për vlerësimin e ndikimeve më të mëdha të projektit në mjedisin jetësor, përshkrimi i masave për parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e ndikimit në mjedisin jetësor, si dhe masat për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Për më tepër, kërkohet përshkrim i ndikimeve të projektit në mjedisin jetësor, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit të shkencës dhe metodat e pranuar të vlerësimit dhe zgjidhjet alternative për zbatimin e projektit që ka pasur investitori, një analizë e vështirësive që ka investitori ose eksperti që është ballafaquar gjatë përgatitjes së studimit dhe në fund një propozim për madhësinë dhe karakteristikat e ndryshimit që e bën të nevojshëm përditësimin e studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor.

Megjithëse rregullorja parashikon që Vlerësimi të ketë përpunim të konsiderueshëm të ndikimit në mjedisin jetësor të të gjithë projektit, si dhe masat për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme dhe në mënyrë të veçantë përcakton në mënyrë specifike që duhet të ketë një përshkrim të llojit dhe sasive të emetimeve të pritshme, por megjithatë, askund nuk deklarohet ndikimi si i nevojshëm dhe që kontribuon ose zbut ndryshimet klimatike.

Sipas Aneksit 1 në lidhje me nenin 4(1) nga Direktiva e BE-së për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor,¹⁷ projektet e mëdha ndërtimore ose zhvillimore në BE duhet së pari të vlerësohen për ndikimin e tyre në mjedisin jetësor. Kjo bëhet përpara se të fillojë projekti. Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor kërkohet për projekte të tilla si: termocentralet bërthamore, linjat e gjata hekurudhore, autostradat, autostradat e shpejta, objektet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme dhe digat e një kapaciteti të caktuar.

Për projektet e tjera, duke përfshirë projektet e zhvillimit urban ose industrial, rrugët, zhvillimin e turizmit dhe kanalizimin, si dhe punime për mbrojtjen nga përmytjet, ju takon anëtarëve individualë të BE-së të vendosin nëse do të kenë një VNM rast pas rasti ose duke vendosur kritere specifike (të tilla si vendndodhja, madhësia ose lloji i projektit).

Vlerësimi i ndikimit mjedisor vlerëson ndikimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit, bazuar në një gamë të gjerë faktorësh që ndikojnë në mjedisin jetësor, duke përfshirë:

¹⁶ Rregullore për përmbajtjen e kërkesave që duhet të plotësojë studimi për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 33/2006

¹⁷ Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisin Jetësor 2011/92/BE dhe amendamenti 2014/52/BE

popullsinë dhe shëndetin e popullatës, biodiversitetin, tokën, ujin, ajrin, klimën, peizazhin, pasuritë materiale dhe trashëgiminë kulturore.

Direktiva e BE-së për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor përcakton gjithashtu rregullat për mënyrën e informimit të publikut për projektin, parashikon një detyrim për VNM-në dhe përshkruan procedurën dhe mënyrën se si të prekurit mund të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Publiku gjithashtu informohet për vendimin pas marrjes së tij dhe më pas mund ta kundërshtojë atë në gjykata.

Procedura e vlerësimit garanton mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe transparencën në procesin e vendimmarrjes për disa projekte publike dhe private. Me qëllimin e tij të gjerë dhe objektivat e tij të gjera, ai siguron që çështjet e mjedisit të jetësorë të merren parasysh që në fillim të projekteve të reja ndërtimi ose zhvillimi, ose ndryshimet ose zgjerimet e tyre. Ai lejon publikun të përfshihet në mënyrë aktive në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. Edhe pse vërehet një nivel i lartë i transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e Maqedonisë, këtu është përcaktuar një mangësi e rëndësishme në aspektin e përmbajtjes së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. Ekzistenca e një shpjegimi të detyrueshëm të faktorit klimatik dhe ndikimit të ndërtimit në aspektin e ndryshimeve klimatike është i nevojshëm dhe duhet të jetë pjesë përbërëse e rregullores. Kjo do të thotë, është e nevojshme të ndryshohet rregullorja ekzistuese në përputhje me direktivën e BE-së.

Në anën tjetër, investitori dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, gjatë përgatitjes, përkatësisht miratimit të Studimit të VNM-së, duhet të kenë parasysh standardet e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, para së gjithash, nga aspekti i:

1

plotësisë dhe përditësimit të të dhënave të përdorura;

2

ndikimin kumulativ të projektit, si dhe i projekteve të tjera të zbatuara në atë rajon, mbi mjedisin jetësor dhe zonat e mbrojtura;

3

parimet e shkallës së lartë të mbrojtjes, kujdesit, parandalimit të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin jetësor të Maqedonisë;

4

qëndrimet e shkencës.¹⁸

KRIJIMI I DETYRUESHËM I RAPORTEVE NDAJ VLERËSIMEVE TË NDIKIMIT NË MJEDISIN JETËSOR

Ligji për Mjedisin Jetësor përcakton raportet për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor si dy mekanizma të veçantë për vlerësimin e ndikimit të zbatimit të aktivitetit të propozuar në mjedisin jetësor dhe masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor gjatë zbatimit të aktivitetit. Për dallim nga vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor, për të cilin ligji parashikon dy forma të pjesëmarrjes së publikut gjatë miratimit të Studimit të VNM-së, procedura e miratimit të raportit për mbrojtjen e mjedisit jetësor nuk parashikon fare pjesëmarrjen e publikut.

Aktivitetet për të cilat hartohet dhe miratohet detyrimisht raporti për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga Drejtoria e Mjedisit Jetësor, përcaktohen me Dekret për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat është hartuar detyrimisht raporti dhe për miratimin e të cilit është përgjegjës autoriteti për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit.¹⁹ Shtojca e Dekretit në seksionin XI pika 14 përcakton se ndërtimi i autostradave është një aktivitet për të cilin duhet të hartohet një raport për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Një rregullim i tillë i çështjes çon në një situatë në të cilën, për ndërtimin e autostradave, hartohet detyrimisht një raport për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për miratimin e të cilit publiku nuk ka të drejtë të marrë pjesë. Ky rregullim i këtillë i materies çon në një situatë në të cilën për ndërtimin e autostradave hartohet detyrimisht një raport për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për miratimin e të cilit publiku nuk ka të drejtë të marrë pjesë. Ndryshe nga situata e rregulluar në legjislacionin e Maqedonisë, Konventa e Aarhus-it, e cila është një nga dokumentet bazë ndërkombëtare për të drejtën e mjedisit jetësor, e rregullon çështjen se publiku duhet të ketë pjesëmarrje pikërisht për projektet që parashikojnë ndërtimin e autostradave.

Nga ana tjetër, aktivitetet për të cilat duhet të kryhet vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor përcaktohen nga Aneksi 1 i Dekretit për përcaktimin e projekteve dhe kriteret në bazë të të cilave nevoja për zbatimin e procedurës për përcaktohet vlerësimi i ndikimeve në mjedisin jetësor.²⁰ Në këtë Dekret rregullohet që vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor duhet të bëhet për ndërtimin e autostradave.


Prandaj, nga këtu arrihet në përfundimin se dy Dekretet, të cilat rregullojnë çështje të ndryshme, përmbajnë të njëjtin aktivitet. Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor është një

¹⁹ Dekreti për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat detyrimisht hartohet elaborat dhe për miratimin e të cilave përgjigjet autoriteti për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit jetësor, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 80/2009, 36/2012, dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 233/2022

²⁰ Dekreti për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet nevoja e zbatimit të procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedisin jetësor, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 74/2005, 109/2009, 164/2012, 202/2016 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 175/2022

nivel më i lartë i analizës së ndikimeve në mjedisin jetësor nga zbatimi i një aktiviteti të caktuar (kohëzgjatja e procedurës, nevoja për përgatitjen e një studimi, pjesëmarrja e detyrueshme e publikut përmes komenteve dhe diskutimit të detyrueshëm publik, e drejta për mbrojtje ligjore për publikun) në krahasim me raportin për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Prandaj, do të ishte e paarsyeshme të pritej që personat që duhet të ndërtojnë autostrada të kryejnë të dy proceset në të njëjtën kohë.²¹

Duhet rregullim më i mirë ligjor dhe shmangia e përplasjes së normave ligjore në akte nënligjore. Për të qenë në përputhje me Konventën e Aarhus-it, nënshkrues i së cilës është RMV-ja, përputhshmëria e duhur me të drejtën e BE-së dhe së fundi për shkak të mbrojtjes adekuate të mjedisit jetësor, autostradat si aktivitet duhet të fshihen nga Dekreti për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat detyrimisht hartohet elaborat dhe për miratimin e të cilit kërkohet nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit jetësor. Dhe ato duhet të mbeten të përcaktuara në Aneksin 1 të Dekretit për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet nevoja e zbatimit të procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedisin jetësor.



²¹ Nisma për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aneksit të pjesës XI pika 14 e Dekretit për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat detyrimisht është hartuar elaborat dhe për miratimin e të cilave është përgjegjës autoriteti për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 80/2009 dhe 36/2012 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 233/2022) në rubrikën «autostrada», dorëzuar nga SHJRM më 5.3.24.

PROGRESI NË NDËRTIMIN E KORRIDOREVE 8 DHE 10-D

2021

Kuvendi i RMV-së në vitin 2021 me ligj²² të veçantë përcaktoi rëndësinë strategjike kombëtare të ndërtimit të korridoreve 8 dhe 10-d. Ligji caktoi konsorciumin “Bechtel and Enka JV” për zbatimin e projektit dhe autorizoi Qeverinë të udhëheqë procesin për lidhjen e një kontrate ndërtimi. Ligji lejon konsorciumin të zbatojë «një proces unik të ndërtimit të Projektit nëpërmjet një metode të shpejtë të planifikimit, ekzekutimit dhe ndërtimit». Me këtë në mënyrë implicite nënkuptohet një trajtim preferencial i partnerit strategjik, pa rregulluar se si do të kryhet “procesi unik i ndërtimit”, duke pasur parasysh ligjet ekzistuese.²³

2023

Deri më tani janë organizuar tri ceremoni, duke përfshirë edhe shpërthimin me mina në afërsi të fshatit Debreshë, që shënoi fillimin e ndërtimit të këtyre rrugëve. Kompania e ndërtimit Enka njoftoi në ueb-faqen e saj në datën 15.11.23, se “punimet e rievimit topografik dhe të hetimit gjeoteknik po ecin me ritme të shpejta”.²⁴ Në publik nuk ka informacion në lidhje me studimin e VNM-së.

Nga informacionet e marra nëpërmjet qasjes së lirë në informacion me karakter publik, mund të konstatohet se, megjithëse në Ligjin për Mjedisin Jetësor nuk është përcaktuar rëndësia e njoftimit për qëllimin, por duke pasur parasysh se pas njoftimit të qëllimit për autostradën A2, pjesa Gostivar - Kërçovë nga viti 2015, nuk është lëshuar Aktvendim/Mendim, e njëjta nuk është e vlefshme. Për më tepër, Njoftimi i qëllimit të vitit 2015 për seksionin A2 Gostivar - Kërçovë është procedurë e filluar në vitin 2015, por duke pasur parasysh se procedura e VNM-së nuk ishte zbatuar plotësisht në vitin 2015, në vitin 2021 është dorëzuar një njoftim i ri për qëllimin për projektin e planifikuar dhe sipas situatës aktuale në mjedisin jetësor në vitin 2021.

Pas njoftimit për qëllimin për autostradën A2 për pjesën Gostivar – Kërçovë në vitin 2015, nuk është kryer asnjë procedurë për VNM-në.

²² Ligji për përcaktimin e interesit publik dhe emërimin e partnerit strategjik për realizimin e projektit për ndërtimin e Korridorit 8 infrastrukturor (seksioni: Tetovë - Gostivar - Bukoçan dhe projekti i autostradës Trebenishtë - Strugë - Qafethanë) dhe Korridorit 10-d (seksioni i autostrada Prilep - Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, «Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut» nr. 163/2021.

²³ Bojana Bozhinovska Siljanovska, 2023, Korridoret 8 dhe 10d - A kemi garanci të mjaftueshme që ndërtimi i autostradave nuk do të ndikojë negativisht në fondin pyjor, SHJRM, Shkup, fq. 4

²⁴ Publikimi për statusin e projektit të autostradës së korridoreve 8 dhe 10-d në ueb-faqen Enka-Bechtel

Nuk ka filluar procedura e VNM-së për autostradën A2 – pjesa Gostivar - Bukojçani. Nuk është publikuar asnjë dokument dhe nuk është nxjerrë asnjë Aktvendim/Mendim për VNM-në. Gjithashtu, nuk ka filluar as procedura për përgatitjen e elaboratit.²⁵

Nga Ndërmarrja Publike Rrugët Shtetërore, pas paraqitjes së kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, është marrë përgjigje se është në proces përgatitja e dokumentacionit të projektit nga kontraktori. Dhe, dokumentacioni i plotë për seksionin konkretë Gostivar-Bukojçan pritet të dorëzohet deri në qershor të vitit 2025, sipas kontratës së nënshkruar.²⁶

Në kuadër të zbatimit të ligjit, gjegjësisht ndërtimit të seksioneve, NPRRSH publikoi Raportin e mbikëqyrjes së ecurisë së punimeve në Korridorin 8 dhe 10d për muajt nëntor dhe dhjetor 2023.²⁷ Në raport thuhet se deri në fund të tetorit 2023 janë përfunduar 58% e shpronësimit të planifikuar të tokës dhe 33% e rilevimit të planifikuar gjeoteknik.²⁸

Neni 81 i Ligjit për Mjedisin Jetësor përcakton procedurën për përcaktimin e nevojës për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor. Njoftimi për qëllimin për realizimin e projektit dhe kërkesa për përcaktimin e nevojës për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor (pra, lista kontrolluese për përcaktimin e nevojës për vlerësim të ndikimit të projektit në mjedisin jetësor), zakonisht dorëzohen së bashku në MMJPH. Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor e njofton investitorin me vendim për nevojën dhe shtrirjen e vlerësimit të ndikimit të projektit në mjedisin jetësor. Ky vendim duhet të publikohet në ueb-faqen dhe të jetë në dispozicion për publikun, por jo gjithmonë publikohet.²⁹

Njoftimi i qëllimit për zbatimin e projektit është publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor³⁰, por jo edhe Aktvendimin nga Ministria. Mospublikimi i Aktvendimit nënkupton edhe pamundësinë e ankesës publike dhe kufizimin e qasjes në drejtësi sipas Konventës së Aarhusit.

Njoftimi i publikuar për qëllimin e realizimit të projektit ndërtimor me interes strategjik për ndërtimin e seksionit të Korridorit 8 të autostradës së Gostivarit përmban një seksion për ndikimin e ndryshimeve klimatike, por në të njëjtën kohë vetë synimi tregon qartë se “pasi që autostrada është një projekt infrastrukturor, i cili është planifikuar të jetë funksional për një periudhë të gjatë kohore, faza pas operacionit nuk është e rëndësishme për shqyrtim dhe analiza e ndikimit për këtë fazë nuk është subjekt i analizës”.³¹ Kjo tregon se efekti afatgjatë i autostradës nuk do të analizohet, veçanërisht për sa i përket ndryshimeve klimatike dhe masave zbutëse që do të ndërmerreshin. Nga ana tjetër, nuk është treguar se efekti kumulativ në mjedisin jetësor do të merret parasysh dhe vlerësohet me ndërtimin e autostradës në këtë seksion, veçanërisht duke pasur parasysh se në të njëjtën kohë do të ndërtohet një autostradë më e gjatë dhe projektet ndahen në disa pjesë.

25 Përgjigje ndaj një kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik nga 17.08.2023, MMJPH

26 Përgjigje në kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik 02-7711/3 datë 29.08.2023, Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore

27 Raporti i mbikëqyrjes së ecurisë së punimeve në Korridorin 8 dhe 10d për muajt nëntor dhe dhjetor 2023, Ndërmarrja Publike Rrugët Shtetërore

28 Извештај Raporti i mbikëqyrjes së ecurisë së punimeve në Korridorin 8 dhe 10d për muajt nëntor dhe dhjetor 2023, Ndërmarrja Publike Rrugët Shtetërore, faqja 7

29 Raporti në Hije, Kapitulli 27 -2023

30 Njoftimi për qëllimin e realizimit për projektin PËR OBJEKTET ME INTERES STRATEGJIK PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT TË KORRIDORIT 8 TË AUTOSTRADËS GOSTIVAR –BUKOJÇAN NËNNDARJA 2A nga KM 0+000 DERI KM 8+430

31 Njoftimi për qëllimin e realizimit për projektin PËR OBJEKTET ME INTERES STRATEGJIK PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT TË KORRIDORIT 8 TË AUTOSTRADËS GOSTIVAR –BUKOJÇAN NËNNDARJA 2A nga KM 0+000 DERI 8+430, fq. 20

RRJET FUNKSIONAL HEKURUDHOR NË RMV - ALTERNATIVË NDAJ TRANSPORTIT RRUGOR

Gjatë përgatitjes së një vlerësimi të ndikimit në mjedis jetësor, Ligji për Mjedisin Jetësor parashikon që opinioni për qëllimin e studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor të projektit duhet të përmbajë në veçanti alternativat që duhet të merren parasysh.³² Për më tepër, gjatë përgatitjes së raportit të vlerësimit të përshtatshmërisë së VNM-së, duhet të përgatitet një seksion që do të marrë parasysh alternativat e projektit.³³

Sipas gjetjeve në «Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV-ë nga këndvështrimi i ndikimit në ndryshimet klimatike», një parakusht kyç për inkurajimin e ndryshimit nga një lloj transporti në tjetrin, nga transporti rrugor në transportin hekurudhor të mallrave, është ekzistenca e një infrastrukture të besueshme dhe të sigurt dhe përdorimi inkurajues i hekurudhave. Ndryshimi nga një lloj transporti në tjetrin lidhet edhe me ndryshimet klimatike, sepse është e rëndësishme të reduktohen emetimet e CO₂. Një nga mënyrat për ta bërë këtë është zgjedhja e transportit hekurudhor për mallrat dhe pasagjerët, pasi emetimet e CO₂ nga ky lloj transporti janë dhjetë herë më të ulëta në krahasim me transportin rrugor, sipas shifrave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit Jetësor.³⁴

Gjatësia e rrjetit hekurudhor në Maqedoninë e Veriut është pak më pak se 700 kilometra. Rikonstruksioni i pjesshëm i rreth 54 kilometrave të hekurudhës së Korridorit 10 është ende në vazhdim. Megjithatë, linjat e mbetura hekurudhore duhet të rehabilitohen, si dhe të modernizohen sistemet e sinjalistikës dhe telekomunikacionit, si dhe të përmirësohen kushtet e stacioneve hekurudhore. Shumica e stacioneve hekurudhore janë ndërtuar sipas standardeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në Konventën Evropiane për Hekurudhat Ndërkombëtare për Transportin e Kombinuar. Rreth 70% e lokomotivave dhe mjeteve motorike u prodhuan midis 1965 dhe 1974. Hekurudha e Korridorit 10 është me një binarë, e elektrifikuar, kryesisht në gjendje mesatare, me dy seksione të rinovuara së fundmi Tabanovcë-Kumanovë 11.6 km dhe Miravci-Smokvicë 12.5 km, që mund të cilësohen si gjendje e mirë. Hekurudha e Korridorit 8 ende nuk është ndërtuar plotësisht.³⁵

Duke analizuar ndërtimin e autostradave dhe mbrojtjen e mjedisit, konstatohet se RMV-ja ka nevojë urgjente për transportin hekurudhor të sigurt dhe funksional, i cili do të shërbejë si një alternativë e përshtatshme për transportin rrugor, i cili karakterizohet si një ndotës i madh.

³² Ligji për Mjedisin Jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 53/2005, Gazeta Zyrtare e RM 89/2022 dhe 171/2022, neni 82

³³ Rregullore për formën, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përgatitjes së raportit për përshtatshmërinë e studimit të vlerësimit të projektit për mjedisin jetësor, si dhe procedurën e autorizimit të personave nga lista e ekspertëve për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor i cili do të përgatisë raportin, Gazeta Zyrtare e RM 33/2006, Neni 3


³⁴ Beti Angelevska dhe Zharko Haxhi Zafirov, 2023, Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV nga këndvështrimi i ndikimit në ndryshimet klimatike, SHJRM, Shkup, fq. 36

³⁵ Beti Angelevska dhe Zharko Haxhi Zafirov, 2023, Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV nga këndvështrimi i ndikimit në ndryshimet klimatike, SHJRM, Shkup, fq. 41

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

- Zbatimi efektiv i projekteve strategjike nuk duhet të bëhet në dëm të instrumenteve tashmë të krijuara të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë dokumentet ndërkombëtare nënshkruese si dhe legjislacionin e saj.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor gjatë ndërtimit të autostradave duhet të përmbajë propozime me atë se si rruga duhet të jetë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike, marrë parasysh në mënyrë kumulative ndikimin në mjedisin jetësor dhe përdorimin e autostradës pas ndërtimit.
- Gjatë ndërtimit të autostradave duhet të zbatohen praktikrat më të mira në dispozicion për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Ndikimi dhe qëndrueshmëria e ndryshimeve klimatike duhet të jenë pjesë e detyrueshme e përmbajtjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisin Jetësor. Kërkohet një transpozim i plotë i direktivës së BE-së në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisin Jetësor në legjislacionin e Maqedonisë dhe aplikimi i praktikave të BE-së në praktikë.
- Ndërtimi i autostradave mund t'i nënshtrohet mekanizmave të ndryshëm (raportet e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor) për vlerësimin e ndikimit të zbatimit të aktivitetit të propozuar në mjedisin jetësor dhe masave për mbrojtjen e mjedisit. Kjo krijon konfuzion dhe pasiguri ligjore.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor është një nivel më i lartë i analizës së ndikimeve mjedisore të zbatimit të një aktiviteti të caktuar në krahasim me raportin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, do të ishte e pajustificuar të pritej që personat që duhet të ndërtojnë autostrada të kryejnë të dy proceset në të njëjtën kohë.
- Nevojitet një rregullim më i mirë ligjor dhe shmangia e përplasjes së normave ligjore në akte nënligjore. Për hir të respektimit të Konventës së Aarhus-it, nënshkruese e së cilës është RMV-ja, për hir të transpozimit adekuat të së drejtës të BE-së dhe në fund për hir të mbrojtjes adekuate të mjedisit jetësor, autostradat si aktivitet duhet të fshihen nga Dekreti për aktivitetet dhe veprimtaritë për të cilat duhet të hartohet elaborat për miratim e të cilit është përgjegjës organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit jetësor. Dhe e njëjta duhet të mbetet e përshkruar në Aneksin 1 të Dekretit për përcaktimin e projekteve dhe mbi kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedisin jetësor.

- Transparenca dhe respektimi i procedurës nënkupton përfshirjen e duhur të publikut dhe respektimin e Konventës së Aarhus-it. Publikimi i rregullt dhe në kohë i dokumenteve në gjuhën maqedonase në ueb-faqen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është i nevojshëm, duke i dhënë kështu publikut dhe ekspertëve mundësinë për të marrë pjesë dhe qasje në drejtësi.
- Infrastruktura e gjelbër është e një rëndësie të veçantë dhe përmirëson cilësinë e mjedisit jetësor, gjendjen dhe lidhjen e zonave natyrore, si dhe shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Prandaj, është e nevojshme të futet «infrastruktura e gjelbër» në legjislacionin e Maqedonisë dhe në planifikimin dhe zbatimin aktual të projekteve të infrastrukturës, duke përfshirë autostradat.
- Duke analizuar ndërtimin e autostradave dhe mbrojtjen e mjedisit, konstatohet se RMV-ja ka nevojë urgjente për transportin hekurudhor të sigurt dhe funksional, i cili do të shërbejë si një alternativë e përshtatshme për transportin rrugor, i cili karakterizohet si një ndotës i madh. Transporti hekurudhor në RMV-ë karakterizohet nga infrastruktura mjaft e vjetër si dhe kompozitat lëvizëse. Duke pasur parasysh këtë, duhet të ndërmerren iniciativa për të mbështetur përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore në të gjitha segmentet, me konsideratë të detyrueshme të qëndrueshmërisë klimatike në proceset e projektimit, procedurën e VNM-së dhe ndërtimin.



LITERATURA E PËRDORUR

- Beti Angjelevska dhe Zharko Haxhi Zafirov, 2023, Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV nga këndvështrimi i ndikimit në ndryshimet klimatike, SHJRM, Shkup
- Ehsan Ashouri, The Impact of Road and Highway Infrastructure on the Environment and Climate Change
- www.statista.com
- Strategjia e BE-së për Infrastrukturën e Gjelbër - përmirësimi i kapitalit natyror të Evropës /* COM/2013/0249
- Strategjia e BE-së për Biodiversitetin 2030 COM(2020) 380
- Plani hapësinor i RM për 2002-2020
- Ligji për Mjedisin Jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 53/2005, 81/2005, 79/2006, 101/2006, 109/2006, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 1/2010, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 187/2013, 42/2014, 44/2015,, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 28/2018, 65/2018, 99/2018 dhe Gazeta Zyrtare e RM 89/2022 dhe 171/2022
- Teodora Obradović Grnčaravska në bashkëpunim me Mariaçara Alberton, Qershor 2020, Focus Report Republic of North Macedonia, EURAC Research Baseline Assessment and Gap analysis of climate change framework, EIA and SEA requirements, with a particular focus on road infrastructure, UNDP, Shkup
- Ligji për Planifikimin Urbanistikë Gazeta Zyrtare e RMV-së 32/2020, 111/2023
- Ligji për ndërtim, Gazeta Zyrtare e RM 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/2013 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/2015, 129/2015, 217/2015, 226/2015, 30/2016, 31/2016, 39/2016, 71/2016, 132/2016, 35/2018, 64/2018, 168/2018 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së 244/2019, 18/2020, 279/2020, 96/2021, 227/2022, 111/2023, 115/2023
- Rregullorja për përmbajtjen e kërkesave që duhet të plotësojë studimi për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin Jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 33/2006
- Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis 2011/92/BE dhe ndryshimi 2014/52/BE
- Bojana Bozhinovska Siljanovska, 2023, Korridoret 8 dhe 10d - A kemi garanci të mjaftueshme se ndërtimi i autostradave nuk do të ketë ndikim negativ në fondin pyjor, SHJRM, Shkup
- Dekreti për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat detyrimisht hartohet një elaborat dhe për miratimin e të cilave përgjigjet autoriteti për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit jetësor, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 80/2009, 36/2012, dhe Gazeta Zyrtare e RSM nr. 233/2022
- Dekreti për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedisin Jetësor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 74/2005, 109/2009, 164/2012, 202/2016 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 175/2022. 175/2022

- Nisma për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aneksit XI pika 14 të Dekretit për veprimtaritë dhe veprimtaritë për të cilat është hartuar detyrimisht një elaborat dhe për miratimin e të cilave është përgjegjës autoriteti për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit (Zyrtare Gazeta e Republikës së Maqedonisë nr. 80 /2009 dhe 36/2012 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 233/2022) në rubrikën «autostrada», e dorëzuar nga SHJRM-ja më 5.3.24
- Ligji për përcaktimin e interesit publik dhe emërimin e partnerit strategjik për realizimin e projektit për ndërtimin e korridorit infrastrukturor 8 (seksioni: Tetovë - Gostivar - Bukojçan dhe projekti për autostradën Trebenishtë - Strugë – Qafëthanë) dhe Korridorit 10-d (seksioni i autostradës Prilep - Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, «Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut» nr. 163/2021
- Përgjigje ndaj një kërkesës për qasje të lirë në informacion me karakter publik nga 17.08.2023, MMJHP
- Përgjigje ndaj një kërkesës për qasje të lirë në informacion me karakter publik nga 02-7711/3 nga 29.08.2023, Ndërmarrja Publike Rrugët Shtetërore
- Raporti i mbikëqyrjes së ecurisë së punimeve në Korridorin 8 dhe 10d për muajt nëntor dhe dhjetor 2023, Ndërmarrja Publike Rrugët Shtetërore
- Njoftimi për qëllimin e realizimit për projektin PËR OBJEKTET ME INTERES STRATEGJIK PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT TË KORRIDORIT 8 TË AUTOSTRADËS GOSTIVAR –BUKOJÇAN NËNNDARJA 2A nga KM 0+000 DERI 8+4300

